



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.497/7 prot.

Tiranë, më 05.06.2024

### V E N D I M

#### Nr.179, Datë 05.06. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 60 Regj., datë 26.03.2024, nga znj. B. Ll, (në vijim ankuesja) kundër Spitalit Rajonal Elbasan, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të *bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja B. Ll, shpjegon se: “*Para një viti jam bërë pjesë e një force politike, jo në pushtet. Jam kryetare e gruas për qarkun e Elbasanit në PSD. Jam 50 vjeç, nënë dhe gjyshe. Nuk jap rezultate dhe efikasitet në punë sikurse një infermiere e re. Jam punonjëse e spitalit prej 34 vite pune ku rreth 20 vite kam punuar me tre turne. Gjendja ime shëndetësore është në raport me moshën paralel. Nuk shoh mirë nga sytë. Sensibiliteti ndaj të sëmurëve më shkakton probleme, dridhje duarsh, shpërqëndrim, ngarkesë emocionale. Shkak tjetër është historia e ngjashme me pacientët që bëjnë kimioterapi e një njeriut tim të afërt, babait tim. Kjo më bën të ndihem në të njëjtën situatë (si atëherë 25 vite më parë). Shkak tjetër është se disa vite më parë jam ndjekur nga një problem shëndetësor i gjirit, të cilin nuk dua ta komentoj më gjatë.*

*Lidhur me mbylljen e pozicionit të punës si infermiere e Ekos, ju bëj me dije se unë jam infermiere e Poliklinikës, jo e Ekos. Mjeku është ai që quhet mjeku i Ekos. Asnjëherë nuk jam paguar si pjesë personeli e imazherisë, infermierë të një aparati quhet infermieri i shiritit të*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

*zembrës, i ezhesë, i fizioterapisë.....Në organikën e spitalit nuk ka dhe nuk jam paguar me këtë pozicion. Ky pozicion është sajuar nga ky drejtor qëllimisht, pas kundërshtimit të transferimit. Për dijeni, infermieri ka qenë prezent në çdo ditë në këtë vënd pune të mbyllur për mua. Më kanë mbyllur mua të drejtën, puna vazhdon.”*

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri:

- Konstatimin e diskriminimit nga Spitali Rajonal Elbasan, për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndësore dhe marrjen e masave të parashikuara nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore, të pretenduara nga ankuesja si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3/1, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Në Kreun II, të këtij ligji parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Konkretisht, neni 12/1/c, i ligjit, ku parashikohet se: “*Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose*

zgjdhjen e kontratës së punës”, ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu trajtimin e tyre gjatë transferimit.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës, me shkresën nr. 497/1 prot., datë 02.04.2024 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankueses iu kërkua plotësimi i kësaj ankese me informacione shtesë si më poshtë:

- “Shpjegime më të hollësishme në lidhje me ndërthurjen e shkaqeve të pretenduara për diskriminim në ankesën tuaj.
- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke dhënë informacion, fakte apo prova se përse mendoni se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet tuaja politike.
- A i keni ekspozuar publikisht, në çfarëdo lloj mënyrë apo mjete, bindjet tuaja politike.
- Në ankesën tuaj shprehni se këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht, në këto kushte, të na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë të depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj”.

Me shkresën nr. 497/2 prot., datë 12.04.2024, ankuesja plotësoi ankesën e paraqitur, e cila është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të ligjit.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 497/3 prot., datë 16.04.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Spitali Rajonal Elbasan, si më poshtë:
  - Informacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e znj. B. Ll.
  - Kopje të librezës së punës dhe kontratës/kontratave të punës të lidhura me ankuesen.
  - Kopjen e plotë të dosjes personale të ankueses.
  - Kopje të urdhrit të transferimit nga detyra të ankueses, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues dhe procedurën e ndjekur (njoftime, procesverbale, urdhra,

*gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës dhe transferimit të saj, si dhe çdo akt ose informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje).*

- *Kopje të Rregullores së Brendshme të Spitalit Rajonal Elbasan.*
- *Kopje e strukturës së vjetër (para ndryshimit aktual) të Spitalit Rajonal Elbasan. Cilat ishin kriteret e vendosura për pozicionin e punës që mbante ankuesja, referuar strukturës së vjetër?*
- *Kopje e strukturës së re, të ndryshuar, të Spitalit Rajonal Elbasan.  
(Bashkëlidhur dhe aktin përkatës ku urdhërohet ndryshimi dhe miratimi i kësaj strukture).*
- *Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të transferuar nga Poliklinika, si pasojë e ristrukturimit të Spitalit Rajonal Elbasan, si dhe pozicionet përkatëse që janë shkurtuar/reduktuar dhe transferuar.  
(Statistika sa ishte dhe sa është aktualisht ky numër).*
- *A është plotësuar pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesja me punonjës tjetër? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion kopje të praktikës së emërimit të punonjësit të ri si dhe dosjen personale të punonjësit.*
- *Informacion nëse urdhri i transferimit nga detyra është ankimuar në gjykatë, nëse po të na vihet në dispozicion kopje e kërkesë padisë.*
- *Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështje.*

Me shkresën nr. 497/4 prot., datë 24.04.2024 është administruar pranë Komisionerit shkresa nr. 566/1 prot., datë 09.04.2024 e Spitalit Rajonal Elbasan, ku rezulton që i është kthyer përgjigje ankueses në lidhje me kërkesën e depozituar në datën 04.04.2024. Në këtë shkresë ndër të tjera i është kërkuar ankueses që të depozitojë një dokument ligjor me anë të cilit të përcaktojë diagnozën e pretenduar në kërkesë, dokument i cili përshkruan saktë paaftësitë profesionale dhe shëndetësore të saj.

Me shkresën nr. 674/1 prot., datë 22.04.2024 Spitali Rajonal Elbasan, ka informuar Komisionerin si më poshtë:

*“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 497/3 prot., datë 14.04.2024, mbërritur në rrugë postare pranë institucionit tonë datë 17.04.2024, në të cilën kërkohet informacion mbi ankesën nr. 60 Regj., datë 26.03.2024, të ankueses znj. B. Ll, kundër Spitalit Rajonal Elbasan, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore, po ju parashtrojmë argumentet tona, si më poshtë vijojnë:*

*Znj. B. Ll, ka filluar punë pranë institucionit tonë në 4 dhjetor 1990 si sanitare. Me diplomimin për “Infermieri të përgjithshme”, 1 mars 2006 emërohet infermiere në spital dhe deri në korrik 2023 ka mbuluar detyrën e infermieres së ECHO-s pranë Shërbimit të Poliklinikës.*

*Në qershor 2023 pranë institucionit tonë vjen për zbatim Urdhri nr. 383, datë 22.06.2023 i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Struktura Organike e Spitalit Rajonal Elbasan”.*

*Sipas ndryshimeve të kryera në strukturën e re organike të Spitalit Rajonal Elbasan, në Shërbimin e Poliklinikës është suprimuar pozicioni i infermieres së ECHO, pozicion të cilin deri në këtë datë e mbulonte infermierja znj. B. Ll.*

*Nga ana tjetër u shtuan vende të lira në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Kemioterapisë (nga 2 infermiere u bënë 6), duke qenë se ky është një shërbim i parë me prioritet jo vetëm nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, po ashtu edhe detyrë e lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si shkak i rritjes së vazhdueshme të rasteve të pacientëve me sëmundje tumoriale, të cilët marrin shërbim pranë kësaj Klinike.*

*Rrjedhimisht u krye transferimi i znj. B. Ll, në pozicionin infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Kemioterapisë, pasi siç theksuam edhe më lart, aty u shtuan 4 vende të reja për infermiere, ndryshe nga struktura e vjetër, ku kishte vetëm 2 vende. Kështu që, pretendimi i ankueses se është diskriminuar në procesin e transferimit të vendit të punës është i pabazuar në prova dhe fakte.*

*Është e rëndësishme të theksohet që ankuesja ka të njëjtin trajtim në pagë dhe po ashtu mbulon vetëm turnin e parë, për shkak të natyrës së punës që ka kjo Klinikë (të sëmurët e kryejnë kemioterapinë vetëm gjatë paradites, ose turnit të parë).*

*Gjatë kësaj periudhe znj. B. Ll, ka dërguar ankesa në mënyrë të vazhdueshme, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe po ashtu pranë institucionit tonë, përgjigje të cilat i gjeni bashkëlidhur kësaj shkresë”.*

2. Me e-mail-in e datës 26.04.2024 Komisioneri i përcolli ankueses shkresën nr. 674/1 prot., datë 22.04.2024 të Spitalit Rajonal Elbasan, për të bërë kundërshtimet e saj në lidhje me këtë përgjigje.

*Me e-mail-in e datës 29.04.2024, ankuesja parashtroi ndër të tjera se: “...Më poshtë po paraqes përgjigjen e shkresës me nr. 674/1 prot. Dokumentacioni që ka dërguar drejtoria në lidhje me dosjen time nuk është i plotë prandaj po ju nis pjesën që i mungon dosjes time. Para disa ditësh drejtoria e spitalit më sjell një letër përgjigje. Këtë letër së bashku me përgjigjen nga ana ime jua kam postuar juve në të njëjtën ditë që ia kam postuar drejtorit.*

*Nga KLSH nuk kisha marrë asnjë përgjigje deri në momentin që e paraqitët ju. Sipas drejtorit KLSH kërkon ti jepet prioritet Sh. Paliativ. Ky prioritet nuk ka cilësi shërbimi terapie me infermiere me probleme shikimi...Në poliklinikë ka plot infermiere të reja aktive, të cilat nuk u cenuan nga kjo strukturë. Poliklinika ka tre kabinete nefrologjie (tre dhoma të ndryshme) që i përkasin tre infermiere në shërbim. Ka tre kabinete reumatologjie (janë tre dhoma dhe tre infermiere), ORL ka dy kabinete, Endokrinologjia ka dy kabinete, Kardiologjia ka dy kabinete.*

*Përse nuk është mbyllur ndonjë nga këto kabinete të cilat kanë një numër të vogël pacientësh vizitash në ditë në raport me Echo-n? Aktualisht Poliklinika ka mjekë pa infermiere. Onkolog, hematolog...*

*Duket qartë se drejtori e ka kërkuar këtë ristrukturim për të vepruar me leje rreth transferimeve, ku vlen të theksohet se vetëm dëshira e infermieres Sh. K., u plotësua, dëshirë të cilën e kishte shprehur hapur”.*

Nga ana e ankueses u vu në dispozicion kopje e një kërkesë-padie, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, kundër Drejtorisë së Spitalit Rajonal Elbasan, me objekt padie: *“Rikthimin në pozicionin e punës. Kompensimin e pagës (vështirësitë si punonjëse e kabinetit të imazherisë prej 2009).”*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.**

Ankuesja është në marrëdhënie pune pranë Spitalit Rajonal Elbasan (Qendrës Spitalore “Xh. Kongoli” Elbasan), që prej 04.12.1990 në pozicionin fillestar si sanitare, fakt ky i provuar bazuar në librezën e punës.

Në datën 01.03.2006, ankuesja është emëruar infermiere dhe palët kanë nënshkruar midis tyre një kontratë individuale për rregullimin e marrëdhënieve të punës, në pozicionin e punës infermiere, kontratë e cila është lidhur me afat të pacaktuar. Marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe Qendrës Spitalore “Xh. Kongoli” Elbasan rregullohen bazuar në dispozitat e Kodit të Punës.

Me shkresën nr. 2005 prot., datë 06.05.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është përcjellë Urdhri nr. 292, datë 06.05.2022, i Ministrit *“Për miratimin e organikës dhe strukturës së Spitalit Rajonal Elbasan”*, sipas skemave përkatëse në këtë strukturë nuk rezultoi të jetë suprimuar pozicioni i ankueses.

Me shkresën nr. 1953/1 prot., datë 22.06.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është përcjellë Urdhri nr. 383, datë 22.06.2023 i Ministrit *“Për miratimin e organikës dhe strukturës së Spitalit Rajonal Elbasan”*, sipas skemave përkatëse ku rezultoi që pozicioni i ankueses të jetë suprimuar.

Me shkresën nr. 1302 prot., datë 25.07.2023 të Spitalit Rajonal Elbasan, është miratuar Urdhri nr. 661, datë 25.07.2023 *“Për një ndryshim në Urdhrit datë 01.03.2006 “Për transferim”*, në të cilin është urdhëruar:



*“1- Znj. B. Ll, aktualisht infermiere në Shërbimin e Poliklinikës transferohet infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë.*

*2- Ngarkohet në ndjekje dhe zbatimin e këtij Urdhri, Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Financës dhe Klinika e Kujdesit Paliativ dhe Njësia e Kemioterapisë.”*

Në lidhje me Urdhrin e Transferimit të mësipërm rezulton që është kundërshtuar nga ankuesja pasi rezulton një korrespondencë si më poshtë:

- Shkresa nr. 1400/1 prot., datë 16.08.2023 e Spitalit Rajonal Elbasan, drejtuar ankueses me anë të cilës i kthen përgjigje në lidhje me kërkesën e datës 16.08.2023, ku e sqaron në lidhje me arsyet ligjore të transferimit të saj por dhe në lidhje me kërkesën ku kërkon transferimin e saj në pozicionin teknike imazherie në spital. Në këtë shkresë spitali informon ankuesen se kjo kërkesë nuk mund të realizohet pasi s’ka pozicione të lira dhe ajo strukturë ka personelin që ka qenë.
- Me e-mail-in e datës 23.08.2023 rezulton që nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, është kthyer një përgjigje në lidhje me çështjen e ankueses dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
- Me shkresën nr. 2433/3 prot., datë 18.09.2023 dhe nr. 2433/5 prot., datë 04.10.2023 nga ana e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, i është kthyer përgjigje ankueses në lidhje me ankesat e saj.
- Me shkresën nr. 1309/1 prot., datë 21.09.2023 rezulton që nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, është kthyer një përgjigje Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, në lidhje me çështjen e transferimit të znj. Ll.
- Në datën 13.03.2024, nga ana e ankueses është bërë një kërkesë tjetër spitalit dhe për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku ka kërkuar që për arsye se është person alergjik dhe puna me medikamente i dëmton shëndetin, ka kërkuar transferimin e saj në Poliklinikë.
- Referuar Akt-Verifikimit të datës 21.03.2024 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi auditimin e ushtruar në Spitalin Rajonal Elbasan, në lidhje me ankesën e znj. B. Ll, rezulton se: *“Nga verifikimi i strukturës organizative të miratuar nga MSHMS me nr. 2005 prot., datë 06.05.2022, për vitin 2022 si dhe struktura me nr. 1953/1 prot., datë 22.06.2023, rezultoi se pozicioni infermier i ECHO, i cili mbulohet nga znj. Ll, është suprimuar. Ndodhur në këto kushte u vlerësua që znj. Ll, duke marrë në konsideratë faktin që për shkak të eksperiencës së saj, transferimi të bëhet në shërbimin e kujdesit paliativ dhe njesisë së kemioterapisë për shkak të natyrës specifike të shërbimit pasi kujdesi paliativ trajton jo vetëm çështjet e vuajtjes-fizike nga sëmundja, por edhe çështje që lidhen me të drejtën njerëzore. Për më tepër znj. Ll, do të mbulojë vetëm turnin e parë për shkak se të sëmurët e kryejnë kemioterapinë vetëm gjatë paradites.*

*Në lidhje me këtë çështje gjithashtu më datën 04.03.2024 u zhvillua një takim ballafaques me znj. Ll, dhe Përgjegjësën e Burimeve Njerëzore, ku iu komunikua znj. Ll, verbalisht vendimi mbi transferimin e saj për shkak të suprimimit të vendit të punës, që vjen për shkak të miratimit të strukturës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.*

*Më pas në lidhje me pozicionin e përcaktuar pranë Kujdesit Paliativ si infermiere në prani të grupit të auditimit iu bë e ditur znj. Ll, që intensiteti apo fluksi i punës është i përbalueshëm pasi ai repart ka disa infermiere dhe mjekë të cilët kanë peshën më të madhe të punës.*

*Gjithashtu iu bë e ditur se duke marrë parasysh faktin që është alergjike nuk do të çenohet apo do ti krijohet vështirësi në procesin e punës. Në shërbimin e Kujdesit Paliativ, znj.Ll, do të mbulojë vetëm turnin e parë.”*

- Me kërkesën e datës 04.04.2024 ankuesja i është drejtuar Drejtorit të Spitalit Rajonal Elbasan, ku sqaron se i është bindur urdhrin të tij për transferim por për arsye të gjendjes së saj shëndetësore dhe ekspozimit me medikamentet që e dëmtojnë atë ka kërkuar rishikimin dhe njëherë të urdhrin të transferimit.
- Me shkresën nr. 566/1 prot., datë 09.04.2024 Spitali Rajonal Elbasan, i ka kthyer përgjigje kërkesës së ankueses me anë të cilës i ka sqaruar: *“Në lidhje me pretendimin tuaj se keni probleme shëndetësore dhe që bëjnë të pamundur vazhdimësinë e punës në Klinikën e Kujdesit Paliativ, ju informojmë se në referim të dispozitave të Kodit të Punës dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, lutemi të paraqisni një raport-ligjor nga KML, i cili përcakton diagnozën e saktë të sëmundjes dhe po ashtu vërteton ligjërisht pretendimet tuaja. Në këto kushte, deri në marrjen e një dokumenti zyrtar (raporti mjeko-ligjor), ku përcaktohet saktë paaftësitë profesionale shëndetësore, lutemi të vazhdoni detyrimet tuaja si punëmarrëse në Spitalin Rajonal Elbasan.”*

Sa më sipër, rezultoi se nga ndryshimet strukturore administrative në bazë të Urdhrin nr. 383, datë 22.06.2023 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale “Për miratimin e organikës dhe strukturës së Spitalit Rajonal Elbasan”, pozicioni i ankueses është suprimuar dhe sipas Urdhrin nr. 661, datë 25.07.2023 “Për një ndryshim në Urdhrin datë 01.03.2006 “Për transferim”, Znj. B. Ll, transferohet infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njësisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë.”

Ndërkohë ky rast është hetuar dhe nga një grup auditues i Kontrollit të Lartë i Shtetit, i cili ka konstatuar që nuk ka shkelje nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan në procedurën e transferimit të znj. B. Ll, dhe se shëndeti i saj nuk çenohet apo t'i krijohet vështirësi në kryerjen e detyrës së saj pranë Klinikës e Kujdesit Paliativ.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të



Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë bindjet politike dhe gjendjen shëndetësore, si shkaqe të mbrojtura. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*<sup>2</sup>, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në gjendjen shëndetësore dhe bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*<sup>3</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit, në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes së barazisë, mundësive ose trajnimit, në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe opinionit politik.

*Karta Sociale Europiane*<sup>4</sup> parashikon të drejtën për punë në nenin 1 të saj. Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër

<sup>2</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>3</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>4</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në nenin 21/1, të Kodit të Punës, kontrata e punës lidhet me shkrim dhe mund të ndryshohet nëse palët bien dakord për ta bërë atë. Referuar pikës 2, të nenit 21, të Kodit të Punës, kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e punës ose shërbimit, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar.

Bazuar në këtë rregullim ligjor të Kodit të Punës, që përbën legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës për rastin e ankueses, Komisioneri vlerëson se pozicioni i punës për ankuesen është ai si infermiere pranë (*Qendrës Spitalore "Xh. Kongoli" Elbasan*) Spitalit Rajonal Elbasan, pa specifikuar pozicionimin konkret apo natyrën e llojit të punës por ka parashikuar që ushtrimi i detyrës së infermieres nga punëmarrësja do të përcaktohet sipas strukturës administrative të punonjësve të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë për Qendrën Spitalore "Xh. Kongoli" Elbasan.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton që nga transferimi ankueses nuk i janë ndryshuar asnjë nga kushtet/detyrimet e parashikuara në kontratën individuale të punës, nga ana e punëmarrësit pasi ajo vazhdon të jetë infermiere e po këtij institucioni, me të njëjtat kushte pune madje dhe më lehtësuese pasi nuk do të punojë me turne, dhe do të marrë të njëjtën pagë. Sipas këtij urdhri transferimi rezulton që kalimi në këtë detyrë i ankueses, të jetë marrë për shkaqe të justifikuara për arsye të suprimimit të vendit të punës dhe bëhet fjalë për lëvizje të brendshme.

Gjithashtu, rezulton se punëdhënësi e ka garantuar ankuesen dhe është konsultuar me të, duke e informuar se natyra e punës nuk paraqet rreziqe të veçanta për shëndetin e saj dhe kushtet janë më të mira dhe më të përshtatshme pasi nuk do të punojë në turnin e natës pasi në shërbimin e Kujdesit Paliativ, shërbimi kryhet paradite dhe në këtë shërbim janë angazhuar dhe infermiere të tjera për arsye të rëndësisë të këtij shërbimi.

Ndërkohë nga ana e ankueses në lidhje me pretendimet mbi gjendjen e saj shëndetësore nuk u vu në dispozicion një dokument ligjor i vlefshëm nga forma dhe përmbajtja (*raport-ligjor nga KML*), i cili të përcaktojë diagnozën e saktë të sëmundjes, dokument i cili i është kërkuar zyrtarisht dhe nga Spitali Rajonal Elbasan.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme lidhur me arsyetimin dhe motivacionin e transferimit të ankueses, pasi ky transferim ka ardhur si rrjedhojë e ristrukturimit të këtij institucioni në funksion të veprimtarisë së tij, ristrukturim i cili është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 383, datë 22.06.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja B. Ll, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Spitali Rajonal Elbasan ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuses B. Ll, në të drejtën për punësim, për shkak gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike, nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**